



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

Komuna Klinë  
01Nr ~~06-4838~~ 18  
Klinë, më, 26.6/2018

## E K S T R A K T - P R O C E S V E R B A L

### Nga takimi me Qytetar

I mbajtur më, **26.6/2018**, në Sallën e Kuvendit Komunal, me fillim në ora: 10:05, në të cilin morën pjesë: Kryetari i komunës ztr. Zenun Elezaj, Besim Hoti, nënkyretar, drejtor të drejtoreve, OJQ-Koha dhe 68 qytetar .

Takimin e hapi Kryetari i komunës i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe tha:

Do të mundohem që ta përfshijë në pika të shkurta punën e ekzekutivit për periudhën gjashtëmjore.

-Viti ka fillua me përgatitjen e projekteve: ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve, mirëmbajtjen e tyre, kanalizimeve, rregullimin e shtratit të lumit "Drini i Bardhë", po shikojmë mundësin e vendosjes së kamerave vëzhguese nëpër qytet, renovimin e objektit të komunës, rrethi rrotullues të sheshi „N.Përlleshi” i cili do të përfundojë brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Po ashtu është shpallur dhe mbyllur tenderi për rregullimin e varrezave të Dëshmorëve në Zajm, por ka dilema për shkak të paraqitjes së çmimeve astronomike, kanali për uitje - Grabanicë, ndërtimi kanalizimit-Zllakuqan dhe Dush, Asfaltimin e rrugëve, Jelloc dhe Poterq i Epërm, Përqevë-Sferk, për rrugën e Poterqit është shpallur fituesi, asfaltimi i rrugës në Drenoc rrëth 800 metra, asfaltimi i rrugës dhe infrastruktura në Krushevë të Madhe, asfaltimi i rrugës Qupevë e lartë, rruga dhe ujësjellësi në Radulloc, rregullimi i rrugës-Kodra në Grabanicë, kemi projekte te kontraktuara të vitit të kaluar, si rruga Budisalc-Stup, rruga Ujmir-Jashanicë, jemi në përgatitje të shpalljes së segmentit të dytë, ka probleme me shtratin e lumit „Drini i Bardhë” të Shk.,,F.Agani” dhe Qendra Rinore.

Duhet theksuar ,se e kemi shfrytëzuar vizitën e Kryeministrit të R.së Kosovës, në komunën tonë, për riaktualizimin e projekteve, ku kemi marr edhe mbështetjen nga ai.

Sa i përketë furnizimit me ujë të pijshëm , fabrika vetëm sa po e zvogëlon kapacitetin furnizues, nga 30 litra në sekond.

Për këtë qëllim e kemi takua kryetarin e Istogut, por s kemi gjete mirëkuptim edhe pse Ligji për ujerat parashefë se burimet e ujërave janë në kompetencë të nivelit Qendror.

Me „ Hidro Drinin” jemi në fazën provuese për fshatin Sferkë, ku nga pardje po ka ujë të pijshëm, po punohet për vendosjen e dy pompave të ujit të pusi i Jardinës.

Problem tjetër është trajtimi i ujërave të zeza, këtu do ta falënderojmë OJQ-n Koha, e cila po na ndihmon në sensibilizimin e takimit me qytetar.

Po punojmë që ti sigurojmë disa ngastra kadastra le të ish pronave Shoqërore të cilat po mundohem me i kthyesh në pronë komunale.

Projekti i ujërave të zeza, po punojmë me Austriakët për të kërkua në emër tonë një Kredi të butë e cila mund të na epet nga BE për Zhvillim dhe Rindërtim.

Kryetari, për ato që i prezantova jemi të gatshëm ti n dëgjoi shqetësimet, vërejtjet dhe kërkesat tuaja.

**-Labinot Krasniqi**, përshëndesë këtë takim dhe pjesëmarrësit, por mungesa e përfaqësuesve të fshatrave është pengesë.

Prezantimi i Kryetarit ishte në detale, ka shumë elemente se një fillim ka qasje të mirë në kontakt me publikun, ju përmendet shumë projekte, por unë do të flasë për rregullimin e shtratit të lumit „Drni i Bardhë” që ka rëndësi jetike për qytetarët e Klinës, uji i pajes po del që gjithmonë të jetë shqetësim dhe se projekti prej:1.7 milion nuk po plotësohet.

Uji i Jardinës, herë pihet herë nuk pihet dhe sot faktikisht nuk ka ujë cilësor për pije, duhet të njoftohet publiku se në cilën periudhë mund të pihet.

Dje ishim në fsh. Grabanicë, ku ka projekte të mëdha do të ishte mirë të kemi përfaqësues edhe nga mjediset tjera.

Problem tjetër kemi mungesën e parkingjeve, parqeve, pra takimi me publikun është i rëndësishëm.

-**Kryetari**, pajtohem i me pjesën dërmuese të fjalimit tuaj, tani kemi projektin e rrerh-rrotullimit, po ashtu edhe të modifikimit të Hartave Zonale.

-**Agim Raci**, në Gjurgjevik të Madhë dy lagje janë mbete pa asfalt, me trego nëse ska, kisha kërkua takim në zyrën tende Kryetar.

-**Kryetari**, mu me intereson me vazhdua financimin për at rrugë, kemi premtim nga Ministri i Infrastrukturës.

-**Zafer Gashi**, marr pjesë me vite në debate publike, është me rëndësi se paraqitja e juaj është për tu vlerësua.

Na intereson se çka është bërë me shëndetësi, sepse me drejtor nuk është qellue, sepse aty po qalon puna, falënderoi për punën e bërë dhe tani banorët e Sferkës kanë ujë të pishëm, por kam frik se nëse nuk ka kontroll për shfrytëzimin e ujit, do të dështojë projekti, edhe të pusi i Jarinës janë bërë investime me i bërë analizat, ku del se ka një mineral magnami.

-**Kryetari**, sa i përketë drejtorit të shtëpisë së shëndetit është zgjedhë me përgatitje profesionale, të kontrollimi i ujit, përgjegjësin e merr Hidrodrini.

Sa i përketë pusit të Jarinës, asnjë herë nuk kam dal kurr me thënë se pihet-nuk pihet, në qytet 60% vjen nga ai pusë ndërsa 40% nga fabrika e përpunimit të ujit.

-**Dedë Deda**, Dresniku i naltë dhe ai i ulët kemi qenë të diskriminuar nga Serbet, ata kishin dy trafa rryme, ne as një.

As pasë lufte nuk pati investime, sa ke LDK-ja në pushtet as një projekt edhe pse na pat premtue Prenk Gjetaj sa ishte Kryetar.

Shkojë LDK-ja, erdhe PDK-ja, me të njëjtin avaz, dy javë para zgjedhjeve dalin KFOR-i, me ta ishte edhe Kryetari Bashota, premtuan dhe nuk na e dhanë zhavorin për shtruarjen e rrugës.

Po me duket se edhe ju sikur ato dy qeveritë e kaluara nuk po ka projekte, andaj kërkoj nga ju Kryetar të shtronit në asfalt rrugën, Klinë-Dresnik.

**-Kryetari**, kemi prue pak zallë, po punohet në projektin e unazës, traseja katër trakshe do të jetë kah ju.

**-Imer Morina**, përf.i fsh.Rixhevë, Kryetar kishit qenë në Rixhevë, pyes se a do të ketë konsultime me përf.e fshatrave, sepse unë nuk jamë ftue at ditë.

**-Kryetari**, kemi qenë me nënkyetarin, tre asamblista dhe disa qytetar që na janë bashkuar, unë do ti marr emrat e kryetarëve të fshatrave.

Të gjithë ata që kemi qenë, kemi kërkua me ditë se a ka rrugicë për këto tri fshatra që ka mbet pa shtrua në zhavorr.

Po ashtu besojmë se rrjeti i Jarinës do të i përfshijë tri fshatrat e juaja.

**-Prenk Doda**, besoj mosë të jepni vetëm premtimë, këto që i thatë, sepse ne jemi kojshi me fshatin tuaj, Krushev e Vogël-Gjyrgjevik, ujësjellësi është instaluar vite më parë, por nuk kemi ujë, si do të veproni ju ztr.Kryetar.

Po ashtu problemi i ujitjes ekziston , sot Krysheva ka 140 banor, më par i kishte rreth 500.po ashtu për rrjetin elektrik, e dimë se është në menagjim të KEDS-it dhe se raportet me komunën janë të vogla, me ka ra me pa gjatë natës dritat janë të dobëta.

**-Kryetari**, këto ditë do të kemi takim me KEDS-in, për ujësjellësin do të bëjmë zgjidhje.

**-Fatmir Berisha**, Gjurgjevik i Madhë, kanalizimi ka mbet në gjysmë, kur do ta filloni fazën tjeter.

**-Kryetari**, kanalizimi do të fillon,të rruga skemi qka me bër për momentin.

**-Sejdi Baleci**,Grabanicë,për kërkesa gjithmonë ju drejtoshem me shkrim,janë bërë do punë,por ka ende nevoja,ne kemi kërkesa për rrugët:Lagja e Morinëve,Beqirëve,e Mullirit,Kodra etj.

Problem janë: Renovimi i shkollës, Ambulantës, zyra e vendit jo funksionale, pastaj edhe penda është në rrezik, kanali për ujite ka mbet në gjysmë, duhen edhe 800 metra.

**-Kryetari**, për këtë vite e kemi rrugën-Gryka, ndërsa vitin tjetër atë Grabanicë-Dugajevë, lagja e Morinëve kemi mendua të jetë në Dollovë, tash po e di në Grabanicë.

Sa i përketë Zyrës se Vendit së shpejti do të vijë zyrtari, te Ambulanta, kemi parapar që të gjitha të rinovohen, i kemi ndarë 40.000 Euro.

**-Përfaqësuesi** i fsh.Dollc, i pata bërë pyetje ish Kryetarit, i cili pak vinte në komunë, se a është me Klinën edhe fshati Dollc.

Me këtë qeverisje a do të kthehet Dollci në komunë, pyet ztr.Leka

Po sikur të rinovohet shkolla e vjetër e ndërtuar në v.1982, mund të përdorët për shtëpi të pleqve etj.

Problem tjetër është rruga dhe kanalizimi.

**-Kryetari**, në buxhetin e v.2019, janë paraparë rruga dhe kanalizimi.

**-Afrim Berisha**, Volljak,punëtor në Suedi ,pyet ,pse nuk ka rrugë me shkue të Liqejt e Mirushës.

**-Kryetari**, zona e Liqejve është e mbrojtur me ligj,vitin e ardhshëm parashifet ndërtimi i disa stazave,po punojmë me sjell donator për një qendër Rekreative.

**-Enver Maloku**,po nisem nga rr.S.Rexhepi,ka probleme me kanalizim,janë dy shakta të hapura,janë ngushtuar hapësirat publike,ska parkingje,ti ruajmë këto pak hapësira që i kemi,rruga deri të ura e drinit duhet ti këtë katër korsi,kufijt e komunave janë bërë si kufijtë shtetëror.

Sa herë është përmend të lidhet rruga Cerovik-Kjev.

**-Kryetari**,të rrugët në klinë,kemi shpallur tender por ska patur as një kompani të interesuar,do ta përsërisim.

Jemi të intëresuar që për dy javë ta kryejmë rrethin të sheshi”N.Perlleshi”.

**-Pal Canaj**, prof.kam një shqetësim me përdorimin e narkotikëve në Shkolla.

**-Kryetari**, të njëtin shqetësim na e ka thënë edhe Kryeministri, pra është shqetësim i të gjithëve kjo dukuri.

**-Regj Morina**, desha të pyes për tri zona të veçanta: „Drini i Bardhë”,Mirusha dhe pusi i Jarinës, këto duhet të ruhen sepse janë me interes për ambientin, shqetësim kemi të ndërtimi i shkollës së re sepse kulmi po pikë.

**-Kryetari**, Sa i përketë pyetjes, për ruajtjen e tokës bujqësore, jemi para një akti të kryer, po mundohemi me i lirua disa .

Të shk.I.Raci, komuna nuk ka as një qasje, Min.e Arsimit vetë e ndërton , vetë e mbikëqyr, më këtë as ne nuk jemi të kënaqur.

Sa i përketë Jagodës, edhe vetë kamë kërkua me e ndërpren punën .

**-Imer Millaku**, kërkesë, në Ujmirë ka mbet keq hekurudha pa stacion pritës.

**-Kryetari**, do të angazhohemi për t'ju sigurua një stre për udhëtarët..

**-Naim Berisha**, Kpuz, keni qenë në Kpuz,na keni premtua kanalizimin për vitin e ardhshëm, dhe për rrugën e Delancave.

**-Kryetari**, projekti i rrithimit dhe fushës sportive janë në projekt, ndërsa rruga e Delancave mbetet për nivelin Qendror.sa i përketë shtruarjes me zhavorr, kanë mbetur afér 100 metra kub që nuk mjaftojnë.

**-Dukagjin Gashi** Dobërdol, kërkon që cilësia e ndërtimit të projekteve të jetë cilësore, të këtë jetëgjatësinë së paku për 30 vite, po ashtu pas shtrimit të asfaltit, pas dy-tri javëve po qitën Policët e shtrirë.

Po ashtu ndërtimi i rrugës Gjurgjevik-Dobërdol, lidhë edhe Rixhevën.

**-Kryetari**, të cilësia keni të drejt, te shtresa e kemi rritë trashësinë edhe për 1 cm, por çmimi i ulët po na i djegë buzët, me kompanin Benita, jemi të kënaqur po i kryen punët mirë.ndërsa për rrugën e Gjurgjevikut ejani një ditë dhe bisedojmë.

**-Fatmir Berisha**, përf.i fsh.Dush, kemi kërkesë me intërvëne të kompania për beton, nevojë kemi edhe për hapjen e një kanali kullues të kroni.

**-Kryetari**, s'do të pranojmë pa u krye punët mirë.

**-Tun Deda**, falënderoj për punën dhe projektet që i keni shpërndare për të gjitha fshatrat, punët e kryera gjatë vitit të kaluar janë të dobëta, mos të jetë gjithmonë vetëm çmimi i vogël kushtë, ju me i kontrollue dhe mos të përsëritën me.

**-Martin Rrustemi** , Gjurgjevik i Vogël, me intereson se a keni një listë prioritare që ta prezantoni para Asamblesë.

-**Kryetari**, jemi i kënaqur që ju shof këtu, mos u ndalni, ejani këtu, jeni të mirëpritur prej meje, përfundon Kryetari Elezaj, në ora:11:55.

Procesmbajtësi,

Zenun Zega

Kryetari i Komunës,

Zenun Elezaj

